

Vendim nr. 251 datë 09.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 09.10.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 25 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATMIR MERKAJ**, përfaqësuar nga avokat Grid Gjojdeshi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 23-2017-661/333, datë 06.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. 20-2017-997/534, datë 26.12.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2025-654 (78), datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 33, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141, 142, si dhe 167 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71/a e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1476, datë 26.02.2010, ka vendosur detyrimin e kërkuarit t'i kthejë një shtetasi shumë 30.241.082 lekë, me interes ditor 4.351 lekë deri në ditën e ekzekutimit. Kreditori ka filluar procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë në lëvizje shërbimin përbarimor privat (zyrën përbarimore "LDC"). Zyra përbarimore, në funksion të vjeljes së detyrimit, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative për një pasuri të paluajtshme (godinë trekatëshe me sipërfaqe 446 m² dhe truall me sipërfaqe 199 m²), të regjistruar në bashkëpronësi të kërkuarit dhe të një personi të tretë, përkatësisht në raportet 40% dhe 60%.

2. Për të ekzekutuar vendimin zyra përbarimore i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesëpadi për pjesëtimin e pasurisë, me qëllim veçimin e pjesës takuese të kërkuarit. Në përfundim të fazës së parë të pjesëtimit, me vendimin e datës 12.04.2013, ajo gjykatë ka vendosur lejimin e pjesëtimit të pasurisë në raportin kërkuar 40% ose 2/5-ën pjesë të sendit dhe personi i tretë 60 % ose 3/5-ën pjesë. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. 440, datë 17.09.2013, ndërsa me vendimin nr. 1699, datë 25.05.2016, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit.

3. Me marrjen formë të prerë të vendimit për fazën e parë të pjesëtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka proceduar me fazën e dytë dhe gjatë gjykimit ka vendosur edhe kryerjen e aktit të ekspertimit për mënyrat e pjesëtimit të pasurisë. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 23-2017-661/333, datë 06.04.2017, ajo gjykatë ka vendosur pranimin e padisë së zyrës përbarimore, lejimin e pjesëtimit të pasurisë, duke përfituar kërkuar 40% ose 2/5-ën në pjesë ideale, dhe personi i tretë 60% ose 3/5-ën në pjesë ideale; njohjen e së drejtës së bashkëpronarëve të mbajnë në pronësi të tyre sipërfaqet e pasurisë sipas variantit të dytë të aktit të ekspertimit; detyrimin e personit të tretë bashkëpronar të kompensojë kërkuarin për sipërfaqen prej 3,20 m² që ai përfiton më shumë, në vlerën 89.600 lekë; si dhe lënien e sipërfaqeve të tjera ambiente të përbashkëta midis dy bashkëpronarëve. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur apel, duke pretenduar, ndër të tjera, se pasuria objekt pjesëtimi është fituar gjatë martesës dhe, si e tillë, pjesa e tij është në bashkëpronësi edhe të bashkëshortes. Sipas tij, vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh këtë fakt dhe nuk e ka thirrur atë në gjykim, duke cenuar kështu të drejtën e bashkëshortes për sa i takon sendit.

4. Me vendimin nr. 20-2017-997/534, datë 26.12.2017, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, duke vlerësuar se ai ishte marrë në respektim të neneve 372 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Për sa u përket pretendimeve të kërkuarit për thirrjen në gjykim të bashkëshortes, gjykata e apelit ka vënë në dukje se në vendimin për fazën e parë të pjesëtimit ishin përcaktuar sendi objekt pjesëtimi, bashkëpronarët dhe pjesët e tyre takuese

dhe, sipas qëndrimit unifikues të Gjykatës së Lartë, problemet e zgjidhura në fazën e parë të pjesëtimit përbënin gjë të gjykuar e nuk mund të merreshin në shqyrtim.

5. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit, duke ngritur të njëjtin pretendim. Me vendimin nr. 00-2025-654 (78), datë 12.02.2025, në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke vlerësuar, ndër të tjera, se pretendimet e kërkuesit për përkatësinë e të drejtave të pronësisë për sendin ishin adresuar drejt nga ajo gjykatë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i fazës së parë të pjesëtimit është *sui generis*, i cili ka zgjidhur në themel dhe në mënyrë përfundimtare çështjet lidhur me sendet që i nënshtroheshin pjesëtimit, rrethin e bashkëpronarëve dhe përkatësinë e pjesëve. Ai kishte marrë formë të prerë, pasi ishin ezauruar të gjitha shkallët e ankimit, duke zgjidhur në mënyrë përfundimtare përkatësinë e pjesëve të secilit bashkëpronar në sendin objekt pjesëtimi. Sipas Gjykatës së Lartë, bazuar në vendimin unifikues nr. 628, datë 15.05.2000 të saj, gjatë fazës së dytë të pjesëtimit të pasurisë gjykata nuk kishte të drejtë të shqyrtonte problemet për gjykimin e fazës së parë. Për pasojë, në përlllogaritjen e pjesëve që u takonin palëve ndërgjyqëse në këtë pasuri, ato ishin pasqyruar saktë në vendimin gjyqësor dhe nuk mund të vlerësoheshin rishtazi, pasi ishin zgjidhur me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit.

6. Në datën 21.07.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, i cili pas plotësimit, sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më 05.08.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1. *E drejta e aksesit*, pasi gjykatat e zakonshme nuk kanë thirrur në gjykim bashkëshorten e tij, e cila, sipas nenit 81 të Kodit të Familjes, përgjigjej solidarisht për të gjitha barrët dhe detyrimet që rëndonin mbi pasurinë, përfshirë detyrimet me karakter kontraktues e jokontraktues. Kjo shkelje nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë, e cila, për më tepër, çështjen e ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit.

7.2. *E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi gjykimi i çështjes në gjykatat e zakonshme është bërë në mungesë të bashkëshortes së tij. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e përsëritura të tij në këtë drejtim.

7.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë. Arsyetimi i saj është në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke u hequr palëve mundësinë për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për pretendimet e tyre.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, që do të thotë se duhet të tregojë se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real. Në këtë drejtim, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket aspektit substancial, individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e drejtpërdrejta të tij, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese (*shih vendimet nr. 77, datë 05.11.2024; nr. 41, datë 29.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuari ka kundërshtuar procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme për fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë, për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, ai e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar. Për sa i takon aspektit substancial, pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me faktin se bashkëshortja e tij nuk është thirrur në gjykimin e pjesëtimit të pasurisë, fakt i cili, sipas kërkuarit, ka shkaktuar cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Mirëpo këto pretendime kanë të bëjnë me të drejtën

kushtetuese të procesit të rregullt ligjor të bashkëshortes së tij dhe jo të kërkuarit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuari nuk justifikon interesin vetjak në çështjen e parashtruar, ndaj, nga pikëpamja substanciale, nuk legjitimohet *ratione personae*.

11. Në këndvështrim të sa më sipër, analiza e mëtejshme e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual të kërkuarit bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

12. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.